

Paketa informative “ Abetare e përbashkët Shqipëri-Kosovë “

Në mbështetje të “ Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe të shkencës”, nënshkruar në Tiranë më 8 mars 2010 dhe hyrë në fuqi më 21 shtator 2010, shpallet kërkesa për tekstet shkollore “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë”, që do të përdoren në vitin shkollor 2012-2013 në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës:

Kërkesa për tekste për vitin shkollor 2012-2013.

Për pajisjen e nxënësve me “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë” në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës për vitin shkollor 2012-2013 do të shpallet konkurrimi për :

1. Abetare për klasën e parë.
2. Abetare - pune për klasën e parë.

Të dy librat formojnë paketë.

Afatet:

a) Data e publikimit të pakos informative	24 nëntor 2011
b) Data përfundimtare e tërheqjes së pakos informative	18 janar 2012
c) Dorëzimi i teksteve	3 prill 2012
d) Shpallja e fituesve	23 prill 2012
e) Periudha e ankimimit	24-29 prill 2012
f) Çertifikimi i tekstit që është fitues	1 - 5 maj 2012
g) Porosia e Abetares	27-31 maj 2012

h) Lidhja e kontratës	10-20 qershor 2012
i) Shpërndarja e Abetares	1 Korrik - 20 gusht 2012
j) Fillimi i shitjes së Abetare .	20 gusht në Kosovë dhe 28 gusht në Shqipëri

Oferta:

Ftohen të gjitha shtëpitë botuese të Shqipërisë dhe të Kosovës, të paraqesin variantet e tyre të Abetares së përbashkët për miratim dhe më pas të marrin pjesë në tregun konkurrues, i cili do të funksionojë në përputhje me vendimin e mësipërm.

Paketa informuese “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë” merret pranë sekretarisë së Komisionit të Miratimit të Abetares (KMA) në MASH Shqipëri dhe MASHT Kosovë me seli në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës në Shqipëri.

Dokumentacioni që merret nga shtëpitë botuese :

Paketa informuese “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë” si dhe çdo material tjetër shpjegues, u jepet vetëm shtëpive botuese dhe sigurohet në sekretarinë e Komisionit të Miratimit të Teksteve në MASH dhe në Zyrën e teksteve shkollore në MASHT.

Tërheqja e programeve mësimore për “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë” me të cilin do të konkurrohet, është e detyrueshme. Afati i tërheqjes është deri në 2 muaj pas shpalljes së paketës informative “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë” .

Pjesëmarrja:

Pranohet vetëm bashkëpunim i përbashkët i shtëpisë botuese shqiptare me shtëpinë botuese kosovare, nëse secila prej tyre e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi të shtetit përkatës.

Hartimi i Abetares së përbashkët Shqipëri - Kosovë .

Hartimi i “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë” bëhet duke respektuar kriteret e përbashkëta të programeve mësimore të dy vendeve. Programet merren së bashku me pakon informative në MASH dhe MASHT.

Paketa e Abetares.

Paketa e “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë” përbëhet nga teksti bazë dhe teksti i punës. Secili prej tyre ka çmimin e veçantë të paraqitur nga botuesi dhe vlerësimin e veçantë të paraqitur nga Komisioni i Vlerësimit të Abetares.

Moskualifikimi i njerit prej tyre në përmbajtjen metodike-shkencore, sjell moskualifikimin e paketës.

Miratimi i paketës së “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë”.

- a. Miratimi i “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë” bëhet nga “Komisioni i Miratimit të Abetares” (KMA), që funksionon në bazë të programit për bashkëpunimin arsimor ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.
- b. Ky komision shpall kërkesën për abetare, standartet e miratimit të tyre dhe shpalljen e tekstit fitues.
- c. Teksti çmohet nga përmbajtja e tij metodike – shkencore, nga çmimi që afrohet, si dhe nga zbatimi i specifikimeve teknike të tij.
- d. Përmbajtjen metodike – shkencore të secilit tekst, e vlerëson Komisioni i Vlerësimit të Abetares (KVA).
- e. Nëse njeri prej teksteve të kërkuar nuk arrin vlerësimin minimal prej 80 pikësh në përmbajtjen metodike - shkencore, nuk shikohet më çmimi. Teksti është i skualifikuar.
- f. Çmimin e afron vetë botuesi, duke u bazuar në formulën e afuar në këtë paketë.
- g. Shpallja e miratimit të fituesit bëhet publikisht në prani të botuesve të përfshirë në proces.

Çertifikimi i tekstit.

- a. Teksti çertifikohet në qoftë se del i pari në konkurimin e pjesëmarrësve dhe plotëson specifikimet teknike të kërkuara të tekstit.
- b. Në rast se nuk plotëson specifikimet teknike çertifikohet teksti i dytë e kështu me radhë.

- c. Renditjen e vendos sasia e pikëve, që fitohet nga shuma e pikëve të vlerësimit të përmbajtjes dhe të çmimit të tekstit bazë dhe të tekstit të punës, sipas një formule të caktuar.
- d. Çertifikimi i tekstit bëhet kur shtëpia botuese sjell dy kopje me kopertinë në KMA, nga të cilat njëra është me firmat e autorëve faqe për faqe. Kopertina e librit duhet të ketë përafrim me përmbajtjen dhe moshën e nxënësit. Ajo nuk mund të përdoret për reklamë të kompanive, individëve, organizatave, etj.
- e. Kur teksti i miratuar është i shtypur dhe është bërë gati për përdorim, shtëpia botuese e paraqet atë në KMA dhe kjo verifikon realizimin apo mosrealizimin e cilësive dhe specifikimeve teknike, në të cilat është mbështetur miratimi i tij. Vetëm pas këtij verifikimi, shtëpia botuese merr çertifikatën e lejes nga KMA-ja për shitjen e “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë”.
- f. “Abetarja e përbashkët Shqipëri - Kosovë” e çertifikuar fiton të drejtën të vendoset në katalogun e teksteve shkollore të dy vëndeve.
- g. Çertifikata e lejes ka afat, të shumtën 3-vjeçar, nëse programet nuk ndryshojnë.
- h. Kontrata që afrohet është njëvjeçare me MASH - in e Shqipërisë dhe MASHT- in e Kosovës.

Shtëpitë botuese:

MASH i Shqipërisë dhe MASHT i Kosovës bashkëpunojnë me shtëpi botuese që japin garanci për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e tekstit brenda afateve të caktuara në këtë paketë informative.

Në konkurrim pranohen vetëm abetare, produkt bashkëpunimi i dy shtëpive botuese nga Republika e Shqipërisë dhe nga Republika e Kosovës. Botues të tjerë nga trevat shqiptare dhe nga diaspora janë të mirëpritur nëse janë në bashkëpunim me botuesit e mësipërm.

Shtëpitë botuese në këtë bashkëpunim janë të detyruara të japin të dhënat e mëposhtme:

- a. Të dorëzojnë në KMA kontratën e bashkëpunimit midis tyre.
- b. Të dorëzojnë në KMA kontratën e bashkëpunimit me autorët e teksteve.
- c. Të dorëzojnë në KMA një listë të plotë të stafit, të kualifikimeve dhe të tranimit profesional sipas departamenteve.

- d. Nje profil te shkurter te dy shtëpive botuese shqiptare dhe kosovare (historia, anet e forta, autoret, etj.)
- e. Të japin të dhënat për autorët e teksteve, sipas formularit bashkëngjitur kësaj pakete.
- f. Të japin të dhënat për realizimin editorial në faqen e brendshme të pakos se abetares.
- g. Të japin vitin e krijimit të saj, adresën, numrin/at e telefonit, adresën elektronike dhe adresën e magazinës së saj .
- h. Për çdo ndryshim të adresës, numrit të telefonit, adresës elektronike, botuesi është i detyruar të njoftojë KMA.
- i. Të bashkëpunoje vetëm me shpërndarës që plotësojnë të gjithë kushtet ligjore.

Shtëpive botuese nuk i lejohet :

- a. Të dorëzojnë tekst pa dy recensa, (njëri nga recensuesit duhet të jetë detyrimisht pedagog efektiv në universitet),
- b. Të dorëzojnë tekst pa redaktor shkencor, pa redaktor letrar, pa disenjues.
- c. Të pranojnë tekste nga autorë që nuk kanë formim universitar.
- d. Të konkurrojnë pa paraqitur katalogun e fundit të botimeve të saj.

Shtëpitë botuese marrin përsipër dhe mbajnë përgjegjësi për:

- a. Marrëdhëniet e tyre me autorët të përbashkët “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë”;
- b. Përgatitjen për shtyp të “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë” origjinale;
- c. Zbatimin e porosive për “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë”;
- d. Shtypjen e “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë”;
- e. Shpërndarjen e “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë”.
- f. Shitjen e “Abetares së përbashkët Shqipëri - Kosovë”.

Shtëpitë botuese janë të detyruara që, në kopertinën e çdo kopjeje të tekstit, të shënojnë çmimin në euro ose lek, barkodin, përpara nxjerrjes së tij në shitje.

Autorët e abetares

- a. Autore te “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë” do të jenë detyrimisht autore nga Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës. Autore të tjerë nga trevat shqiptare dhe diaspora janë të mirëpritur.
- b. Autorët i rregullojnë marrëdhëniet me shtëpitë botuese nëpërmjet kontratave që lidhin me to.

- c. Nuk lejohet që një autor i përmbytjes së abetares, të konkurrojë, me më shumë se një libër, në shtëpi botuese të ndryshme, që marrin pjesë në këtë konkurrim.

Konflikti i interesit

Punonjësi i MASH-it të Shqipërisë, MASHT-it të Kosovës dhe agjensive vartese të tyre nuk mund të jenë autorë të ekipit të paketës së të "Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë".

Kur punonjësi ose personi ka konflikt interesi atëherë konflikti zgjidhet në bazë të legjislacionit përkatës të Shqipërisë dhe Kosovës.

Vlerësimi i Abetares

- Abetarja vlerësohet nga përmbytja e saj metodike – shkencore, nga çmimi i saj dhe nga realizimi i specifikimeve teknike.
- Përmbytja e saj metodike shkencore vlerësohet nga Komisioni i Vlerësimit të Abetares (KVA). Ai përbëhet nga specialistë të lëndës, të cilët janë nga Shqipëria, nga Kosova, ndoshta dhe nga trevat e tjera shqiptare e diaspora. Komisioni i Vlerësimit të Abetares punon me kriteret e vlerësimit dhe standartet e vlerësimit. Çështjet vlerësohen në mënyrë të pavarur nga secili vlerësues.
- Vlerësimi i përgjithshëm i abetares del nga formula $S = S_1 + 0.6S_2$ ku S_1 paraqet sasinë e pikëve të fituara nga libri bazë dhe S_2 paraqet sasinë e pikëve të fituar nga libri i punës.

Specifikimet teknike të teksteve të kërkuara:

Nr.	Titulli	Numri preventive i faqeve	Formati i prerë (në cm.)	Numri i ngjyrave të bllokut	Numri i ngjyrave të kopertinës	Lloji i lidhjes
1	Abetare	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
2	Abetare- pune	80	20.7x27.7	4	4	ngjitje

Shënime të rëndësishme:

Për titullin " Abetare "

- Letra që do të përdoret për bllokun e librit të jetë jo më pak se 90 g/m², përjashtohet përdorimi i çdo lloj letre me llustër.
- Kopertina të jetë me kartonçinë të tipit "matt" ose " simcot" me peshë jo më pak se 350g/m².
- Fashikujt të qepur me penjë.
- Bashkimi i bllokut me kapakun me ngjitje me hotmelt.

Për titullin “ Abetare – pune”

- Letra që do të përdoret për bllokun e librit të mos jetë më pak se 80 g/m²; përjashtohet përdorimi i çdo lloj letre me llustër.
- Kopertina të jetë me kartonçinë të tipit “matt” ose “ simcot” me peshë 250-260 g/m².
- Bashkimi i bllokut me kapakun me ngjitje me hotmelt. Lejohet lidhja me tel kaluar, me të paktën 2 kapje.

Koefiçientët e formulës së vlerësimit të çmimit

Nr.	Titulli	B	b
1	Abetare	600	54
2	Abetare -pune	289	26

Vlerësuesit e Abetares.

- Vlerësuesit janë pedagogë universitar, të mësues të shkollave të mesme, mësues të shkollave 9 vjeçare .
- Vlerësuesi duhet të studiojë shumë mirë programet lëndore të dy vëndeve. Vlerësuesi nuk jep opinion për programet, po jep vlerësim për realizimin e këtij programi në tekstin shkollor.
- Vlerësuesi i kushton vëmendje të posaçme objektivave dhe në veçanti objektivave specifike, nëse këto janë në program.
- Vlerësuesi studion me vëmendje dhe plotëson me përgjegjësi të plotë, tabelën e kriterëve të vlerësimit.
- Vlerësuesi përpara fillimit të punës plotëson dokumentacionin e mospasjes së konfliktit të interesit

Kriteret e vlerësimit të Abetares në përmbajtje.

- Teksti kualifikohet në përmbajtje kur merr vlerësimin 80 deri në 100 pikë.
- Teksti nuk kualifikohet në përmbajtje nëse argumentohet plotësisht njera nga deklaratat e mëposhtme :
 - Ka gabim shkencor të fushës që i përket.
 - Ka përkufizime të gabuara.
 - Ka gabime gjuhësore të theksuara.
 - Ka interpretime të gabuara të një çështje.
 - Ka një diferencë të theksuar ndërmjet ngarkesës mësimore të tekstit me moshën e nxënësit për të cilin është ky tekst.
 - Bie në kundërshtim me ligjet ekzistuese të barazisë së shtetasve.

- Dominon në të fryma e urrejtjes dhe nxitja e armiqësisë ndaj popujve të tjerë.
- Nuk respekton programin mësimor në masën mbi 10 % të tij.
- Ka fryme të theksuar nacionaliste ose antipatriotike.
- Ka pjesë që bien në kundërshtim me kodin e etikës dhe të moralit të shoqërisë në të cilën ai zbatohet.
- Ka ilustrime krejtësisht të gabuara që nuk kanë lidhje me temën që trajtohet.
- Paraqet shkrime anonime të diskutueshme, pa vlera.
- Jep të dhëna të vjetra që nuk janë realiste sot.

Standartet e vlerësimit të Abetares.

a) Tabela e vlerësimit të paketës së “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë”

Nr.	Çështja që vlerësohet	Min.	Max.
	Vlerësuesi nr. 1		
1	Saktësia shkencore		20
1.1	A ka teksti saktësi shkencore ?	2	5
1.2	A është i drejtë interpretimi i fakteve ?	1	2
1.3	A paraqet teksti shkrime anonime të diskutueshme, pa vlera ?	0	3
1.4	A është treguar kujdes për të nxjerrë faktet themelore të temës mësimore, mënyra e paraqitjes së tyre, e kuptueshme, e fshehur etj ?	0	2
1.5	A ka paraqitur teksti konceptet themelore të programit apo ka zgjatje të panevojshme ?	0	2
1.6	A janë zgjedhur drejte emerat e femijeve dhe toponimeve gjeografike?	0	3
1.7	A përcjellin mesazhe pozitive copat e leximit ? A janë në përshtatje me moshën ?	0	3

	Vlerësuesi nr. 2		
2	Përshtatja e njohurive me moshën shkollore		22
2.1	A është vëllimi i njohurive në përshtatje me moshën ?	0	2
2.2	A respekton teksti barazinë gjinore, racën, kombësinë, fenë, parimet demokratike, mosdiskriminimin etj. ?	0	2
2.4	Teksti dallohet për fraza të gjata dhe të vështira për t'u kuptuar apo fjali të shkurtra dhe të qarta ?	0	2
2.5	Sa nxitet motivimi i marrjes së njohurive të reja në temat mësimore ?	0	2
2.6	A respekton teksti programin mësimor ?	0	2
2.7	A ka teksti gabime apo interpretime të gabuara ?	0	2
2.8	A ka pjesë leximi që bien në kundërshtim me kodin e etikës dhe të moralit të shoqërisë në të cilën ai zbatohet.	0	2
2.9	A janë zgjedhur drejt në përshtatje me moshën copat e leximit ?	0	2
2.10	A janë zgjedhur fjalët e përshtatshme për shtimin e fjalorit të nxënësve ?	0	1
2.11	A përcjell teksti ndjenjën e dashurisë për atdheun ?	0	2
2.12	A përmban teksti pjesë të integruara me lëndët e tjera, si histori, gjeografi, shkencë etj.	0	3
	Vlerësuesi nr. 3		
3	Prezantimi dhe ilustrimet		18
3.1	A kanë lidhje në faqet e ilustruara, përmbajtja e figurës me përmbajtjen e tekstit në këtë faqe ?	0	3
3.2	A e ndihmon teksti edukimin atdhetar të nxënësve ?	0	3

3.3	Sa nxit autori i tekstit, motivimin e nxënësve për njohuritë e reja ?	0	2
3.4	Standarti, cilësia e ilustrimeve, estetika librit, stili.	0	3
3.5	A ka teksti aparatën e nevojshëm për të zhvilluar shprehitë e njohurive tek nxënësit ?	0	2
3.6	A janë prezantuar drejtë objektivat e lëndës ?	0	2
3.7	A ka teksti gabime apo interpretime të gabuara ?	0	2
	Vlerësuesi nr. 4		
4	Përzgjedhja e pjesëve të leximit.		22
4.1	Sa e ndihmon nxënësin teksti me detyra të pavarura ?	0	3
4.2	A e ndihmon teksti edukimin atdhetar të nxënësve ?	0	3
4.3	A dallon teksti për një trajtim të qartë të njohurive ? Copat e leximit apo letërsisë a kanë vlera edukative ?	0	2
4.4	Si janë trajtuar zbatimet praktike të njohurive në tekst ?	0	2
4.5	A ka teksti gabime apo interpretime të gabuara ?	0	2
4.6	A respekton teksti programin mësimor ?	0	2
4.7	A ka pjesë leximi që bien në kundërshtim me kodin e etikës dhe të moralit të shoqërisë në të cilën ai zbatohet.	0	3
4.8	A janë zgjedhur drejte emrat e femijeve dhe toponimeve gjeografike?	0	3
4.9	A dallon teksti për njohuri të tepërta që kapërcejnë moshën e nxënësve ?	0	2
	Vlerësuesi nr. 5 (mësuesi i gjuhës shqipe)		18

5	Saktësia gjuhësore		6
5.1	Si është shkruar teksti nga pikëpamja e gjuhës letrare ?	0	2
5.2	A ka teksti gabime gjuhësore ?	0	3
5.3	Gjuha e përdorur është në varësi të moshës së nxënësit apo jo ?	0	2
6	Libri i mësuesit dhe autorësia.		12
6.1	Sa e ndihmon mësuesin libri i mesuesit ?	0	6
6.2	Vlerësimi autorëve të përmbajtjes së tekstit	1	6
6.4	Vlerësimi reçensuesve	Kusht kualifikues	
			100
	Vlerësimi përfundimtar i përmbajtjes	80-100	

Çmimi i Abetares

Formula e pikëve të çmimit është
$$p = 55 \frac{B}{\zeta + b}$$

ku:

- B dhe b kanë vlera të dhëna në tabelën e koeficienteve për çdo tekst më vete
- ζ është çmimi në lek që zgjedh botuesi
- p është numri i pikëve që përftohen për çmimin e zgjedhur nga botuesi.

P.sh.: për tekstin “Abetare” të klasës së parë, në tabelën e koeficienteve janë dhënë $B=600$ dhe $b=54$. Nëse botuesi zgjedh çmimin 400 lekë atëherë pikët që fiton për

çmimin llogariten kështu
$$p = 55 \frac{600}{400 + 54} = 72.7$$

Numri i pikëve rrumbullakoset me një shifër pas presjës.

Në qoftë se teksti është vlerësuar me 91 pikë atëherë vlerësimi i përgjithshëm për tekstin e abetares është $91+72.7=163.7$. Ky është numri S_1 i formulës.

Në të njëjtën mënyrë veprohet dhe për fletoren e punës (numri S_2).

Dokumentat që botuesi dorëzon për paketën e “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë”.

Botuesi që aplikon për miratim teksti, dorëzon në KMA, në MASH, dokumentet e kualifikimit dhe ofertat përkatëse, si më poshtë:

(Të gjitha dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer në shqip dhe të noterizuara).

Dokumente kualifikimi

- a. Vendimi i gjykatës për regjistrimin si person juridik, me të drejtë ushtrimi aktiviteti si Shtëpi Botuese.
- b. Çertifikatë regjistrimit në organet tatimore për ushtrimin e veprimtarisë në biznesin e botimit.
- c. Vërtetim nga Gjykata që Shtëpia Botuese dhe administratori që aplikon në emër të saj, nuk janë në ndjekje penale.
- d. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve dhe e Taksave për shlyerjen e detyrimeve përkatëse.

Shënim: Dokumentet e pikave c) dhe d) duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë muaj nga data e dorëzimit në MASH.

Dokumentet e ekipit realizues të tekstit dhe të shpërndarjes së tij

- a. Deklaratë e botuesit dhe e autorëve, që nuk janë në rast të konfliktit të interesave, për të qenë respektivisht pjesëmarrës në tregun konkurrues të teksteve dhe autorë të tekstit, përkundrajt punësimit të tyre në administratën publike të arsimit, të parashikuar në këtë Paketë Informuese (modeli bashkëngjitur).
- b. Deklaratë e të drejtave të autorësisë (kopirajt-it) mbi origjinalitetin e veprës në tërësi dhe pjesëve të saj si dhe kopje të akteve ose marrëveshjeve që mund të jenë bërë për aplikimin për marrjen e lejes ose blerjen e elementeve të veçanta të kopirajt-it nga të tretët (modeli bashkëngjitur).

- c. Deklaratë për specifikimet teknike të tekstit që dëshmon respektimin e specifikimeve minimale të vëna, si dhe formatin e zgjedhur të tekstit (modeli bashkëngjitur).
- d. Kontrata ndërmjet botuesit dhe autoreve.
- e. Deklarata për çmimin e shitjes së tekstit (modeli bashkëngjitur).
- f. Të japin të dhëna për autorët e teksteve (modeli bashkëngjitur).
- g. Të japin të dhëna për ekipin realizues të tekstit si: redaktorin shkencor, redaktorin letrar, etj. (modeli bashkëngjitur).
- h. Të paraqesin dy recensa për vlerësimin e tekstit, ku detyrimisht njëri nga recensuesit të jetë pedagog efektiv në universitet.
- i. Të japë vitin e krijimit të shtëpisë botuese, adresën e saj, numrin e telefonit, adresën elektronike dhe adresën e magazinës së saj nga do të shpërndahen librat në qarqe (modeli bashkëngjitur).

Materiali i tekstit që paraqitet për miratim

- a. 5 kopje të tekstit që paraqitet për miratim, secila me 100% të materialit të tekstit, tërësisht i redaktuar nga ana shkencore, metodike dhe gjuhësore, i faqosur me gjithë figurat, ilustrimet, skicat, hartat e ngjyrat (nëse parashikohen) etj., i shtypur dhe i prerë në trajtë përfundimtare, në llojin e letrës dhe formatin e përzgjedhur sipas specifikimeve teknike, ashtu siç do të dalë nga shtypshkronja.
- b. Në çdo tekst të jetë bashkëngjitur lista e të dhënave të autorëve, një kopje, pa identifikuar emrat e tyre dhe botuesin.
- c. Të dorëzojë dy recensat e vlerësimit të tekstit, pa identifikuar emrat e recensuesve, shtepine botuese dhe autorët.
- d. Çdo kopje e tekstit të paraqitur të jetë e lidhur në trajtë provizore me vrime e me kapëse plastike me ngjyrë të bardhë ose të zezë, pa përdorur si ballina (kopertinë) kartoncinë apo film.

Shënim:

Asnjë prej kopjeve të tekstit ose të paketës së tekstit, që paraqiten për miratim nuk duhet të përmbajnë shenjat e zakonshme të identifikimit (kopertinën, autorët, emrin apo logon e shtëpisë botuese, etj.), siç do të ishte në gjendjen gati për shitje. Titulli i tekstit në kopjet e dorëzuara duhet të vendoset sipas emërimit në listën e kërkuar dhe të shpallur nga MASH-i dhe jo i stilizuar sipas karakterit të linjës që ka ndjekur shtëpia botuese apo autorët e tekstit. Titulli i stilizuar mund të rivendoset pas miratimit të mundshëm. Titulli të shkruhet me ngjyrë të zezë në llojin e letrës së bllokut të librit, me gërma të mëdha shtypi tip "Bookman Old Style", bold, me madhësi 36-she.

Mënyra e paraqitjes së dokumenteve dhe materialeve

Dokumentat vendosen ne dy zarfe, nga të cilat njeri është i dyllosur dhe tjetri është i padyllosur.

Zarfi i dyllosur:

Në një zarf të bardhë me format A₄, që dorëzohet i mbyllur e i dyllosur nga botuesi, vendosen sipas radhës të gjitha “Dokumentet e ekipit realizues të tekstit dhe të shpërndarjes së tij” nga pika a) deri në i).

Zarfi duhet të jetë pa shenja të jashtme dalluese, që do të mund të zbulonin përkatësinë e tij. Dokumentet e këtij zarfi janë të gjitha të firmosura e, sipas rastit, të vulosura.

Zarfi i padyllosur:

Krahas zarfit të dyllosur me dokumentet e tekstit, dorëzohet dhe një zarf i padyllosur, i bardhë me format A₄, me kopje të dokumentave sipas pikave c) dhe e) të “Dokumentet e ekipit realizues të tekstit dhe të shpërndarjes së tij”.

Në këtë rast, këto dokumente nuk do të përmbajnë firma, apo vula si dhe çfarëdo shenjë tjetër, që do të mund të lejonin identifikimin e origjinës së tyre (si p.sh, logo, emri, vula apo firma e botuesit ose autorëve etj.). Në rast të kundërt, teksti përjashtohet nga procesi i aplikimit dhe i vlerësimit.

Çdo tekst që paraqitet për miratim ka zarfin e vet të dyllosur dhe atë të padyllosur.

Materiali i tekstit që paraqitet për miratim

- a. Kopjet e tekstit që paraqitet për miratim paketohen në letër të bardhë. Mbi çdo pako botuesi shkruan titullin e tekstit. Në çdo pako të futen zarfi i dyllosur dhe zarfi i padyllosur i titullit përkatës.
- b. Kopjet e tekstit si dhe materialet e paketimit duhet të jenë pa shenja ose tregues që do të mund të lejonin identifikimin e autorit ose botuesit. Në raste kur verifikohen shkelje të tilla, teksti përkatës përjashtohet nga procesi i aplikimit dhe i vlerësimit.

Pranimi dhe ruajtja e fshehtësisë së dokumenteve dhe materialeve

- a. Zarfi me dokumentet e kualifikimit hapet nga marrësi në dorëzim, në çastin e dorëzimit dhe në prani të dorëzuesit - përfaqësues i botuesit. Përmbajtja e tij konstatohet në çast dhe dokumentet ruhen nga marrësi në dorëzim. Në të kundërt, aplikimi i botuesit nuk pranohet për verifikim të mëtejshëm.

- b. Në çastin kur e gjithë paketa merret në dorëzim, marrësi në dorëzim heton për shenja të jashtme të mundshme në pakot. Nëse nuk gjenden të tilla, më vonë, mbi secilën kopje të tekstit të dorëzuar si dhe në të dy zarfet e dokumenteve të teksteve vendoset i njëjti kod që jep përkatësinë e zarfeve me kopjet e teksteve.
- c. Zarfi i dyllosur mbahet i veçuar në një vend të sigurt. Zarfi i padyllosur mbahet edhe ai i veçuar dhe hapet nga KMA-ja vetëm mbasi janë caktuar vlerësimet me pikë për përmbajtjen e tekstit dhe teksti ka kaluar me sukses fazën e parë të miratimit, atë të përmbajtjes.
- d. Zarfi i dyllosur që mbahet në kasafortë hapet në çastin e shpalljes së përfundimeve të vlerësimit të teksteve, para të gjithë botuesve të pranishëm, pjesëmarrës në konkurrim. Pasi të jenë shpallur më parë rezultatet e miratimit sipas kodeve, hapen zarfet e dyllosura, në prani të gjithë botuesve dhe zbulohet përkatësia e tekstit të miratuar me botuesin, sipas kodeve të vendosura në zarfe dhe në pakot e tekstit. Botuesi të cilit rezulton se i përkasin të dhënat e zarfit, i dorëzon aty për aty komisionit kopjen e vet të tekstit për të verifikuar edhe një herë njëjtësinë me kopjet që i përkasin atij zarfi, pra, nëse është njëlloj me ato që janë dorëzuar në datën e pranimit. Për këtë qëllim, botuesi duhet të ketë një kopje identike të tekstit, për të vërtetuar përkatësinë dhe këtë duhet ta sjellë me vete ditën e shpalljes së teksteve të miratuara. Më tej, shqyrtimi i posaçëm i dokumenteve që përmban zarfi i dyllosur, përfundon me konfirmimin ose jo të miratimit të tekstit përkatës.
- e. Dorëzimi i teksteve nga botuesit bëhet nga secili botues veç e veç, sipas radhës së paraqitjes. Nuk pranohen aplikime pas përfundimit të afatit.
- f. Dokumentat e dorëzuara, nuk kthehen.

Kontrata e marrëveshjes me MASH të Shqipërisë

K O N T R A T Ë

Sot, më datë2013, në Tiranë, lidhet kjo kontratë, midis palëve:

MASH: **Ministria e Arsimit dhe Shkencës** (më poshtë e quajtur **MASH**), e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm
.....

dhe

BOTUESIT: **Shtëpia Botuese**(më poshtë e quajtur **BOTUESI**), e përfaqësuar nga

BAZA LIGJORE E KONTRATËS

Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 850 e në vijim, ligji nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” i ndryshuar, ligji nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar; VKM nr. 107, datë 10. 02. 2010 “ Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar.

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekt i kësaj kontrate është sipërmarrja e botuesit për botimin, shpërndarjen dhe shitjen tek nxënësit e shkollave të sistemit arsimor parauniversitar të tekstit “.....”, me autorë, i shpallur i miratuar nga MASH-i nëpërmjet Komisionit të Miratimit të Abetares (KMA) pranë kësaj Ministrie.

NENI 2

TË DHËNAT TEKNIKE QË DUHET TË PLOTËSOJË TEKSTI

Specifikimet teknike minimale që do të plotësojë teksti në përfundim të procesit të shtypjes janë:

- Formati i librit:
- Numri i ngjyrave të bllokut të librit:
- Lloji dhe gramatura e letrës së bllokut:
- Numri i ngjyrave të kopertinës së librit:
- Lloji dhe gramatura e kartonçinës:
- Lidhja e librit:
- Numri i faqeve:

NENI 3

ÇMIMI I TEKSTIT

Çmimi i shitjes me pakicë i tekstit të jetë jo më i lartë se lekë.

NENI 4

CERTIFIKATA E LEJES E TEKSTIT

Teksti duhet të ketë fituar Çertifikatën e Lejes për t'u futur në tregun e shitjes. Çertifikimi i tekstit bëhet nëpërmjet KMA-së, përpara se teksti të shitet dhe përpara se të shpërndahet nga botuesi për përzgjedhje nga Komisionet e Përzgjedhjes së Teksteve (KPT) në shkolla.

Botuesi detyrohet që, deri në marrjen e Çertifikatës së Lejes për këtë tekst, të plotësojë të gjitha vërejtjet, sipas rastit, nëse ka të tilla, të cilat do t'i jepen nga KMA-ja.

Çertifikimi i tekstit merret kur plotësohen të gjitha kushtet që janë vënë në paketën "Abetare e perbashket Shqipëri - Kosovë".

NENI 5

PULLA E ÇERTIFIKIMIT

Në çdo kopje të tekstit të certifikuar, vendoset pulla e certifikimit, e cila jepet nga MASH-i përkundrejt pagesës, në vlerën e kostos së blerjes nga MASH-i.

Kopjet e tekstit, që do të futen në treg duhet të kenë pullën e certifikimit, të ngjitur në kopertinë.

NENI 6

TË DREJTAT E PALËVE

A. MASH-i ka të drejtë:

1. Të përfshijë në sistemin konkurrues edhe tekste të tjera alternative, që marrin miratimin dhe certifikimin nëpërmjet KMT-së.
2. Të kontrollojë herë pas here cilësinë e kopjeve të tekstit, të hedhura në qarkullim për të verifikuar përmbushjen e standardeve të miratimit.
3. Të pezullojë qarkullimin e tekstit kur konstaton se botuesi nuk ka përmbushur standardet e miratimit.
4. Të ndrojë porosinë në qoftë se teksti nuk ka shkuar në shkollë 10 ditë përpara fillimit të shkollës

B. Botuesi ka të drejtë:

1. Të zotërojë, së bashku me autorin/autorët e tekstit, të drejtën ekskluzive të pronësisë intelektuale mbi tekstin dhe si mall në shitje (kopirajtin), e drejtë e rregulluar me kontratën ndërmjet tyre dhe e mbrojtur nga ligjet në fuqi.
2. Të nxjerrë tekstin në shitje të lirë, vetëm nëse, paraprakisht, e ka paraqitur tekstin për përzgjedhje në shkolla dhe ka përmbushur porositë e shkollave për këtë tekst.

NENI 7

DETYRIMET E PALËVE

A. MASH-i detyrohet:

1. Të kryejë kontrollin përfundimtar të përmbajtjes dhe të specifikimeve teknike nëpërmjet KMA-së dhe në rast të përmbushjes së standardeve, t'i japë botuesit,

Çertifikatën e Lejes, brenda 1 jave, nga data që botuesi dorëzon: kërkesën me shkrim dhe dy kopje të tekstit të shtypur.

2. T'i japë botuesve 1-2 mjedise në shkollë për shitjen e librave, pa qera, për një periudhë kohore një mujore, duke filluar 2 javë përpara fillimit të vitit të ri shkollor.
3. Të përfshijë tekstin e miratuar në Katalogun e Botimeve Shkollore, pasi të jetë lëshuar Çertifikata e Lejes.
4. Të pajisë botuesin me listën e shkollave që mund ta përzgjedhin këtë tekst në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
5. Të marrë masat me shkollat, DAR-et ose ZA-të për funksionimin e rregullt të strukturës së përzgjedhjes së teksteve nga shkollat.
6. Në rastin kur teksti është për shkollat e pakicave kombëtare ose për nxënësit romë të marrë masa që shkollat, DAR-et ose ZA-të, të kryejnë pagesat ndaj botuesit për tekstet e furnizuara, sipas porosive të shkollave, nëse teksti subvencionohet tërësisht nga shteti.
7. Të ndjekë një politikë të barabartë dhe të drejtë me të gjithë botuesit, të cilët do të fitojnë të drejtën e botimit, shtypjes dhe shitjes së tekstit tek nxënësit, për përdorim në shkolla.

B. BOTUESI detyrohet:

1. Që, me mjetet e tij dhe duke marrë përsipër rrezikun, të prodhojë tekstin dhe ta shesë atë sipas kërkesave të shkollave,
 - a) duke respektuar sistemin e përzgjedhjes së tekstit prej tyre;
 - b) duke përmbushur porositë e shkollave;
 - c) duke mos u tërhequr nga këto detyrime në asnjë fazë të përmbushjes së tyre.
2. Të mos ia kalojë të drejtat e këtij teksti një botuesi tjetër, pa marrë më parë pëlqimin e MASH-it, për aq kohë sa Çertifikata e Lejes është e vlefshme.
3. Gjatë dy javëve përpara fillimit të shkollës të ketë furnizim të rregulltë me tekstet shkollore që i përkasin botuesit, që nënshkruan këtë kontratë.
4. Të mos dërgojë në shkollë ose qendrat e komunave libra të tjerë jashtë katalogut dhe pa hologram.
5. Të urdhërojë shpërndarësin t'i japë tekstet romëve kundrejt pagesës që do ta marrë më vonë nga shteti.
6. Të paraqesë pranë KMA-së 2 kopje të tekstit të shtypur për verifikimin e cilësisë së përmbajtjes dhe asaj fizike, me qëllim që të marrë Çertifikatën e Lejes. Njëra nga kopjet detyrimisht duhet të jetë firmosur në çdo faqe nga autori (autorët) i (e) tekstit. Për të marrë këtë çertifikatë, botuesi duhet të ketë respektuar plotësisht

standardet gjuhësore dhe shkencore, specifikimet teknike sipas nenit 2, çmimin e miratimit sipas nenit 3, si dhe kërkesat e tjera të kësaj kontrate për elementet që duhet të përmbushë çdo kopje e tekstit .

7. Të mos e fusë tekstin në sistemin e përzgjedhjes në shkolla dhe të mos e nxjerrë atë në shitje, pa marrë Çertifikatën e Lejes.
8. Të mos fusë në tekst, material reklamues të çdo lloji për veten ose çfarëdo biznes, individ apo veprimtari tjetër.
9. Të vendosë ISBN-në, çmimin, barkodin dhe simbolin e botuesit, në kopertinën e tekstit dhe të pajisë çdo kopje të tij me pullën me hologramë të çertifikimit, përpara nxjerrjes së tekstit në treg.
10. Të shesë tekstet e çertifikuara në shkolla duke respektuar kërkesat e kësaj pakete.
11. Të pranojë porosi nga shkollat për llogari të nxënësve si blerës.
12. Çdo shtëpi botuese të ketë furnizuar shkollat përkatëse me të gjithë sasinë e librave të porositur, 10 ditë përpara fillimit të vitit të ri shkollor.
13. Të mos e nxjerrë në shitje të lirë tekstin pa furnizuar më parë nxënësit në shkolla.
14. T'u shesë me lekë në dorë nxënësve tekstet e porositura nga shkollat. Nëse teksti është për shkolla të pakicave kombëtare ose për nxënësit romë, sasia e porositur e teksteve të çohet në shkollë, e shoqëruar me faturën tatimore.
15. Për librat e shitur me lekë në dorë, t'i lëshojë blerësit dokumentin e shitjes ose faturë të kasës fiskale, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave.
16. Të mos e shesë tekstin si pjesë të ndonjë pakoje (me tekste të tjera, fletore, materiale mësimore etj.).
17. Të mos veprojë ndryshe nga mënyra e përcaktuar në këtë kontratë për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e tekstit , për të cilin ka marrë Çertifikatën e Lejes.
18. Të rregullojë me kontratë plotësimin e detyrimeve të mësipërme kur ka të tretë.

NENI 8

VLEFSHMËRIA E KONTRATËS

- 1 Kjo kontratë është e vlefshme për vitin shkollor 2012-2013.

NENI 9

SANKSIONET

1. Për shkeljet, të paktën të një prej paragrafëve të nenit 6 të kontratës, nga botuesi, ai përjashtohet nga e drejta për të paraqitur tekste për miratim në të ardhmen pranë MASH-it në KMT, për aq kohë sa ta gjykojë të arsyeshme MASH-i.

NENI 10

1. Pas nënshkrimit, kjo kontratë nuk mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga botuesi. Në rast se kjo ndodh, MASH-it i lind e drejta të përjashtojë botuesin nga e drejta për të marrë pjesë në sistemin e miratimit të teksteve dhe botuesi detyrohet të paguajë të gjithë dëmin që i ka shkaktuar MASH-it nga prishja e kontratës. Llogaritja e dëmit bëhet nga MASH-i. Njëkohësisht, kur teksti është me një alternativë, botuesi detyrohet që t'ia kalojë, përkundrajt vleftës, të drejtat e botimit, shpërndarjes dhe shitjes së këtij teksti, një botuesi tjetër, i cili u nënshtrohet të gjitha detyrimeve të kësaj kontrate, për aq kohë sa është e vlefshme Çertifikata e Lejes.
2. MASH-i nuk mund ta zgjidhë këtë kontratë në mënyrë të njëanshme, përveç rasteve kur konstatohen shkeljet dhe mosplotësimi i detyrimeve të botuesit të përmendura në këtë kontratë. Nëse MASH-i e prish kontratën pa shkaqe të arsyeshme, detyrohet të paguajë të gjithë dëmin që i ka shkaktuar botuesit.

NENI 11

MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve zgjidhen me mirëkuptim. Në të kundërt, zgjidhja e tyre bëhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

NENI 12

TË PËRGJITHSHME

Kjo kontratë nënshkruhet në 3 (tri) kopje origjinale, nga të cilat 2 (dy) i merr MASH-i dhe 1 (një) botuesi. Kjo kontratë hyn në fuqi, pasi nënshkruhet nga të dyja palët.

PËR MINISTRINË E ARSIMIT

PËR SHTËPINË BOTUESE

DHE SHKENCËS

Kontrata e marrëveshjes me MASHT të Kosovës

<Emri i Autoritetit Kontraktues> ("**MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË**"),

TITULLI I KONTRATËS:

Numri i Prokurimit: < MASHT/110049-236>

Neni 1 Ligji i zbatueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-02/L-99. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë.

Neni 2 Lënda

2.1 Lënda e kontratës duhet të jetë [mallrat], [dërgesa], në [Masht,] nga Kontraktuesi, i [furnizimeve], në vijim:

2.2 Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik [duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar].

2.3 [Furnizimet të cilat përbëjnë lëndën e kontratës duhet të shoqërohen me pjesë rezervë të përshkruara nga Kontraktuesi në Kuotimin e tij] dhe nga [pajisjet shitesë / artikujt tjerë të nevojshëm për shfrytëzimin e mallrave gjatë një periudhe prej siç është e specifikuar në instruksionet për Tenderuesit].

2.4 Vendi i pranimit të [furnizimeve], do të jetë (**Masht**), afatet kohore për dërgesën do të jenë [3 ditë.] dhe Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ Periudha e dërgesës do të vazhdojë prej datës së nënshkrimit të kontratës nga ana e të dy Palëve

2.5 Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i furnizimeve me shifra: €;

dhe me fjalë:

3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

3.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës.

Neni 4 Origjina

¹ DDP - Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2000 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

4.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

4.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Që furnizimet të importohen në vendin e Autoritetit kontraktues, duhet të përfshihen të gjitha pagesat dhe tatimet e zbatueshme për importimin e tyre, duke përfshirë edhe TVSH-në.

Neni 6 Dorëzimi

6.1 Dorëzimi i [furnizimeve], [shërbimeve] do të bëhet në kohën, vendin dhe mënyrën siç është specifikuar në dosjen e tenderit dhe në kushtet e kontratës.

6.2 [saktësoni periudhën e fillimit të ekzekutimit]

6.3 Kontraktuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin e përkohshëm në destinacion. Furnizimet duhet të pakëtohen në atë mënyrë që të parandalohet dëmi ose keqësimi i tyre gjatë transportit deri në destinacion.

6.4 [Saktësoni ndonjë kërkesë specifike të paketimit]

Neni 7 Variacionet

7.1 Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën që, në kohën e kontraktimit, t'i ndryshojë sasi të parapara në Kushtet e veçanta. Vlera totale e furnizimeve mund të mos rritet dhe as të bjerë si rezultat i variacionit të sasive për më tepër se [10 %] të çmimit të kontratës. Çmimet e njësisë që janë përdorur në ofertë do të zbatohen edhe për sasi të prokuruar me variacion.

Neni 8 Cilësia e furnizimeve

8.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

8.2 [Tregoni këtu dokumentet që duhet të sigurohen dhe nëse ka nevojë, procedurën e përdorur nga Autoriteti kontraktues]

Neni 9 Garancia

9.1 Kontraktuesi duhet të garantojë që furnizimet janë të reja, të papërdorura, të modelit më të fundit dhe që inkorporojnë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe në material. Kontraktuesi do të garantojë edhe se asnjë nga furnizimet nuk kanë asnjë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria.

9.2 Garancia do të mbetet valide për [12] muaj, pas pranimit të [furnizimeve], [shërbimeve].

Neni 10 Vonesat e ekzekutimit

10.1 Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrinë t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.

Neni 11 Inspektimi dhe testimi

11.1 Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuar në Kushtet e veçanta.

11.2 [Shtësoni vendet/mallrat që do të inspektohen dhe testohen dhe marrëveshjet praktike për testim]

11.3 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Kontraktuesit.

11.4 Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

11.5 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen.

11.6 Furnizimet do të pranohen nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit.

Neni 12 Nën-kontraktimi

12.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 5 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Nuk mund të nënkontraktoj më tepër se 40 % të vlerës së kontratës.

Neni 13 Pagesat

13.1 Pagesat do të bëhen në euro. Autoriteti kontraktues do t'i paguajë Kontraktuesit shumën e obligimit brenda [30] ditësh pas datës në të cilën është regjistruar pagesa e pranueshme.

Neni 14 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

14.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Kontraktuesit **shtatë ditë** paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur kontraktuesi nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d). Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Kontraktuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës; i) Nuk arrinë të jap garancinë për funksionim të mirë të mallrave.

Neni 15 Ndërprerja nga ana e Kontraktuesit

15.1 Kontraktuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues **14 ditë** paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Kontraktuesit shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) E pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se [180] ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Kontraktuesit.

Neni 16 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

16.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda [30] ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

16.2 [saktësoni Gjykatën Kompetente, ose Organin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve].

Neni 17 Komunikimet

17.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

E hartuar në gjuhën [shqipe] dhe [serbe] dhe [angleze] në tri origjinale, dy për Autoritetin Kontraktues dhe një për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:		Emri:	
Pozita:		Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

TË DHËNA PËR AUTORËT E TEKSTEVE

Grupi i autorëve :	Po	Jo
Autor i vetëm, pedagog	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Autor i vetëm, mësues	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Dy ose më shumë pedagogë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Dy ose më shumë mësues	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Pedagog dhe mësues	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Më shumë se dy mësues dhe pedagogë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Formimi universitar: (Titulli i diplomës që zotëron)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Brenda vendit :	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Jashtë vendit :	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Formimi pasuniversitar dhe titulli shkencor/ akademik:

Titulli	Brenda vendit	Jashtë vendit
-Master	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
-Doktor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

-Profesor i Asociuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
-Profesor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
-Akademik	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Përvoja pedagogjike:

-Mësues i lëndës ____ vjet

-Pedagog i lëndës ____ vjet

Veprimtari botuese në 10 vitet e fundit:

-Numri i artikujve divulgativë si autor i parë ose i dytë: _____

-Numri i artikujve shkencorë si autor i parë ose i dytë: _____

-Numri i monografive:____, Libra artistikë:____, Vepra të tjera_____

(si autor i parë ose i dytë)

-Numri i teksteve mësimore, si autor i parë ose i dytë, për arsimin 9-vjeçar: _____

-Numri i teksteve mësimore, si autor i parë ose i dytë, për arsimin e mesëm: _____

-Numri i teksteve mësimore, si autor i parë ose bashkautor, për arsimin e lartë: _____

TË DHËNA PËR REDAKTORËT SHKENCORË DHE REDAKTORËT LETRARË

1. Për redaktorët shkencorë:

a) Redaktori i parë

Shkolla e kryer:	I punësuar në _____
	Punëdhënësi _____

b) Redaktori i dytë (nëqoftëse ka)

Shkolla e kryer:	I punësuar në _____
	Punëdhënësi _____

2. Për redaktorët letrarë:

a) Redaktori i parë

Shkolla e kryer:	I punësuar në _____
------------------	---------------------

	Punëdhënësi _____
--	-------------------

b)Redaktori i dytë (nëqoftëse ka)

Shkolla e kryer:	I punësuar në _____
	Punëdhënësi _____

DEKLARATË PËR PAJTUESHMËRINË ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Deklaroj se asnjë prej autorëve, recensuesve ose redaktorëve shkencorë dhe letrarë (emër mbiemër firmë), si më poshtë:

_____, dorëzuar për miratim pranë Komisionit të Miratimit të Abetares.

Deklaroj, po ashtu, se Shtëpia Botuese _____ nuk është e lidhur me interesa familjare ose financiare me punonjës të këtyre institucioneve.

Data

BOTUESI

Shënim:

Dorëzohet një kopje me emrin, firmën dhe vulën e botuesit, e mbyllur dhe **e dyllosur** në zarfin A4 të bardhë e pa shenja të jashtme.

DEKLARATA PËR TË DREJTËN E BOTIMIT

Deklaroj se “ E drejta e botimit” e tekstit

_____ /
dorëzuar për miratim pranë Komisionit të Miratimit të Abetares:

Pjesa e tekstit ose teksti në tërësi	Zotëruesi	Burimi
1. _____	_____	_____
2. _____	_____	_____
3. _____	_____	_____
4. _____	_____	_____
5. _____	_____	_____
6. _____	_____	_____
7. _____	_____	_____
8. _____	_____	_____
9. _____	_____	_____
10. _____	_____	_____

Data _____

BOTUESI

Shënim:

1. Si **pjesë të tekstit**, për efekt kopirajt-i, mund të përfshihen edhe ilustrime, ide, punë editoriale. Zotërimi i kopirajt-it nga subjekti përkatës duhet të dëshmohet në kontratën përkatëse midis autorëve dhe botuesit ose me dokumente të blerjes apo dhurimit të kësaj të drejte nga të tretë, kopje të noterizuara të të cilave përfshihen bashkëngjitur. Në rastet kur kopirajt-i është fryt i punës origjinale të vetë subjektit, në kolonën e tretë për **burimin e kopirajt-it** shënohet punë origjinale. Në kolonën e burimit të kopirajt-it shënohet, sipas rastit: origjinale, ose nga të tretë (shënohet në kllapa pala e tretë dhe përfshihet dokumenti i blerjes apo dhurimit).
2. Dorëzohet një kopje me emrin, firmën dhe vulën e botuesit, e mbyllur dhe **e dyllosur** në zarfin A4 të bardhë e pa shenja të jashtme.

DEKLARATA PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË TEKSTIT

Deklaroj se specifikimet teknike për Abetaren e përbashkët , dorëzuar për miratim pranë Komisionit të Miratimit të Abetares në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë janë si më poshtë:

1. Blloku i librit:
 - a) Numri i ngjyrave _____
 - b) Gramatura e letrës _____
2. Kopertina e librit
 - a) Numri i ngjyrave _____
 - b) Gramatura e kartonçinës _____
 - c) Lloji i kartonçinës _____
3. Lloji i lidhjes së librit _____
4. Format i librit _____

Data _____

Botuesi

DEKLARATËN PËR ÇMIMIN E TEKSTIT

Deklaroj se çmimi i shitjes së “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë” , dorëzuar për miratim pranë Komisionit të Miratimit Abetares është

_____ Lekë.

(Me shifra dhe fjalë)

Data ___/___/_____

BOTUESI

Shënim:

Dorëzohen dy kopje identike, në këtë mënyrë:

1. Një kopje pa emër, pa firmë, pa vulë apo logo të botuesit, si dhe pa shenja që zbulojnë identitetin e botuesit, e mbyllur, por jo e dyllosur në zarfin A4 të bardhë e pa shenja të jashtme.
2. Një kopje me emrin, firmën dhe vulën e botuesit, e mbyllur dhe **e dyllosur** në zarfin A4, të bardhë e pa shenja të jashtme.

DEKLARATË PËR AUTORËSINË E TEKSTIT

Deklaroj se autorët e “Abetare e përbashkët Shqipëri - Kosovë”, dorëzuar për miratim pranë Komisionit të Miratimit Abetares :

Emri	Pjesa e tekstit (kapitujt ose thjesht bashkautorësi)
1.	
2.	
3.	
4.	

Data ___/___/_____

BOTUESI

Shënim:

Dorëzohet një kopje me emrin, firmën dhe vulën e botuesit, e mbyllur dhe **e dyllësuar** në zarf A4, të bardhë e pa shenja të jashtme.